



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.91, datë 20.11.2018**

**PËR**

**“SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË GRUPIT TË INSPEKTIMIT, PËR  
PENALIZIMIN ME MASË ADMINISTRATIVE KRYESORE GJOBË SI DHE DËNIME  
PLOTËSUESE NDAJ SUBJEKTIT TË INSPEKTUAR “UNIFI HOLDINGS INC, DEGA  
NË SHQIPËRI””**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), me pjesmarrjen e :

1. Z.Illir	Zela	Kryetar
2. Znj.Edlira	Dvorani	Anëtar
3. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
4. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 20.11.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, për penalizimin me masë administrative kryesore gjobë në vlerën 50.000.000 lekë si dhe shqyrtimin e propozimit për dhënien e dënimeve plotësuese, ndaj subjektit të inspektuar “Unifi Holdings INC, dega në Shqipëri”**

## **BAZA LIGJORE:**

1. Neni 132 e vijues i Ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji 9918/2008*);
2. Neni 46 i Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë (*ligji 10433/2011*);
3. Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 44/2015*);
4. Ligji Nr.10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative” (*ligji 10279/2010*);
5. Rregullore Nr.46 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendim Nr.2695, datë 27.10.2016 (*Rregullore nr.46*);
6. Rregullore e Brendshme e Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;

## **KËSHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Autorizimin e Inspektimit Nr. 1719/8 Prot., datë 06.09.2018;
2. Vendim për shtyrje të Autorizimit të Inspektimit Nr. 1719/10 Prot., datë 01.10.2018;
3. Procesverbalin e Inspektimit Nr. 224, Datë 26.10.2018;
4. Relacionin shpjegues nga grupi i inspektimit;
5. Shkresë datë 13.11.2018, nr. 1719/16 Prot nëpërmjet të cilës sipërmarrësi Unifi Holdings INC dega Shqipëri, është njoftuar për t’u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 20.11.2018 përpara Këshillit Drejtues të AKEP (marrë dijeni në datën 13.11.2018 nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar të subjektit).
6. Projekt- Aktin e formatuar dhe arsyetuar;
7. Dosje e plotë e Inspektimit.

## **V Ë R E N:**

1. Në Vendimin Nr. 54. datë 03.08.2018 Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur dhënien e masës administrative kryesore me “Paralajmërim” ndaj sipërmarrësit Unifi Holdings INC, Dega Shqipëri, si dhe realizimin pranë këtij subjekti të një inspektimi të ri, brenda datës 30.09.2018.
2. Në zbatim të vendimit të mësipërm është miratuar Autorizimi i Inspektimit Nr.1719/8, datë 06.09.2018, për kryerjen e një inspektimit ri të subjektit Unifi Holdings INC, Dega Shqipëri

Referuar ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike ne R.Sh”, ligjit Nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në R.Sh” si dhe Rregullores Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit”, inspektorët e AKEP kryejnë kontrollin dhe Inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike. Ndër parimet themelore të inspektimit është “Parimi i proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit” që do të thotë se në kryerjen e inspektimit, inspektori kryen veprimet e inspektimit në mënyrë të tillë që të ndërhyjë në veprimtarinë e subjektit të inspektimit vetëm për atë që është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të inspektimit. Në këtë aspekt, subjektit objekt inspektimi i është kërkuar nga Grupi i Inspektimit informacion dhe dokumentacion mbi veprimtarinë e zhvilluar gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017, pra për tre vitet e fundit duke marrë në konsideratë faktin se ky subjekt nuk ishte inspektuar për më shumë se tre vjet.

Me arsyen objektive të kompleksitetit të çështjes dhe nevojës për një kohë më të gjatë për shqyrtimin e dokumentacionit të mbledhur nëpërmjet Vendimit Nr. 1719/10 Prot., datë 01.10.2018, afati për kryerjen e inspektimit është shtyrë deri në datën 12.10.2018.

3. Grupi i inspektimit të AKEP, ka ushtruar veprimtarinë inspektuese pranë sipërmarrësit “Unifi Holding INC, dega Shqipëri”, veprimtari e cila është konkluduar me Procesverbalin e Inspektimit Nr. 224, Datë 26.10.2018. Në bazë të procedurës inspektuese, referuar Rregullores nr.46, “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, subjekti “Unifi Holdings INC, dega në Shqipëri” është njoftuar paraprakisht nëpërmjet komunikimit elektronik (e-mail i datës 07.09.2018), për inspektimin e ri që do të kryhet duke i dërguar edhe një kopje të skanuar të autorizimit si dhe dokumentacionit (listë kontrolli) që duhet të dispononte. Subjektit ju kërkuar dokumentacioni përkatës për të gjitha pikat e renditura në Autorizimin e Inspektimit nr.1719/8, date 06.09.2018 dhe dokumentacioni si më poshtë:

- *Kopje të Autorizimit të Përgjithshëm, dhënë nga AKEP;*
- *Kontratën tip me përdoruesit miratuar nga AKEP ku ofronte shërbimin internet;*
- *Lista e përdoruesve të shërbimit internet;*
- *Kopje të kontratës me provaiderin për shërbimin internet;*
- *Faturë shërbimi të detajuar për përdoruesit e shërbimit internet;*
- *Certifikatat e miratimit të pajisjeve që janë në përdorim;*
- *Lista e punonjësve me sigurime shoqërore;*
- *Kohën e fillimit të matjeve të Treguesve të Cilësisë së Shërbimit, në zbatim të pikës 1 dhe pikës 2 të Nenit 11 të “Rregullores për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”;*
- *CD me shtrirjen hartografike të rrjetit si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për plotësimin e objektit të inspektimit.*

4. Më datë 24.09.2018 përfaqësuesit ligjor të sipërmarrësit i kanë dorëzuar grupit të inspektimit dokumentacionin e renditur si më poshtë:

- *Autorizim përfaqësimi dt. 10.09.2018*
- *Ekstrakt i printuar nga QKB*
- *Njoftim për caktim dhe përdorim numeracioni,*
- *Shkrese nr. 91/1, date 13.01.2010 e AKEP me objekt dërgim konfirmimi njoftimi,*
- *Konfirmim njoftimi*
- *Formular njoftimi për NSPC*
- *Certifikate e konfirmimit te njoftimit 12.03.2013.*
- *Njoftim për fillim/ndryshim/mbyllje shërbimi dt 29.03.2011,*
- *Njoftim për fillim/ndryshim/mbyllje shërbimi dt 30.09.2009,*
- *Marrëveshje reciproke midis Unifi Communication sarl dhe Unifi Holdings dega Shqiperi e dates 16.12.2015.*
- *Marrëveshje interkoneksioni ndërkombëtar midis Vodafone Albania dhe Unifi INC, dega Shqiperi e dates 01.07.2014*
- *Marrëveshje shërbimi midis Vodafone Al dhe Unifi SARL, dt 18.12.2015.*
- *Faturë shitje sipas kontratës se mësipërme datë 30.06.2017.*
- *Faturë blerje e marre nga dega ne lidhje me shërbimet e faturuara sipas kontratës se mësipërme. (fature dt 30.06.2017)*
- *Deklarim i punemarrësve për muajt tetor 2014 dhe prill 2018*
- *Pasqyrat financiare 2015, 2016 dhe 2017.*

5. Në vijim të procedurës inspektuese, sipërmarrësi “Unifi Holdings INC, dega Shqipëri”, është njoftuar (e-mail i datës 05.10.2018) se grupi i inspektimit duhet të kryente verifikimin e adresës (selisë së subjektit), të cilën subjekti ka deklaruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe në AKEP. Përfaqësuesit e “Unifi Holdings INC dega në Shqipëri”, në një deklaratë me shkrim të paraqitur grupit të inspektimit janë shprehur se:

- Selia e “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” ndodhet në adresën: Rruga “Qemal Stafa” Kompleksi Fratari, Suite 1, Kati 4, Porcelan, Tiranë. Me vendim të datës 14.08.2018, aktiviteti i degës në Shqipëri është pezulluar (vendim i depozituar dhe i aksesuar në QKB) dhe rrjedhimisht në këtë adresë nuk zhvillohet më asnjë aktivitet.
- Duke qenë se dega ka pezulluar veprimtarinë nuk ka punonjes dhe aktivitet, dhe adresa e deklaruar është thjesht për marrjen e dokumentacionit.

6. Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga përfaqësuesit e autorizuar të subjektit objekt inspektues, evidentoi faktin se sipërmarrësi “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” me NIPT K92430001J ka nënshkruar një Marrëveshje Interkoneksioni me “Vodafone Albania” sha të datës 01.07.2014. Sipas parashikimeve të kësaj marrëveshje, “Unifi Holdings INC, dega Shqipëri” do të ofrojë shërbim të tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare, hyrëse dhe dalëse, për sipërmarrësin “Vodafone Albania”. Bazuar në të dhënat që subjekti “Unifi Holdings Inc dega në Shqipëri” ka depozituar pranë inspektorëve për inspektimin e kryer si dhe në AKEP për të ardhurat (pasqyrat financiare të çertifikuara nga organet tatimet) rezulton se subjekti nuk ka kryer aktivitet në vitet

2014, 2015 dhe 2016 dhe ka deklaruar të ardhura nga komunikimet elektronike vetëm për vitin 2017. Gjithashtu rezultojnë se në funksion të kësaj marrëveshje marrdhënia kontraktuale midis Vodafone Albania sha dhe Unifi Holdings INC dega Shqiperi me Nipt K92430001J ka filluar qe në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, (referuar edhe Faturë Tatimore Shitje datë 01.08.2014 me nr serie 0113816872, drejtuar blerësit Unifi Holdings INC me numër identifikimi K92430001J, paraqitur nga vetë përfaqësuesit e autorizuar të subjektit).

7. Në vijim të procesit të inspektimit, me qëllim kontrollin e saktësisë së të dhënave të deklaruara nga sipërmarrësi “Unifi Holding INC, dega Shqipëri”, grupi i inspektimit me shkresën nr.1719/11 prot, datë 11.10.2018, ka kërkuar informacion nga sipërmarrësi “Vodafone Albania” në lidhje me MI e nënshkruar me sipërmarrësin objekt inspektimi, dhe konkretisht lidhur me sasinë e trafikut të shkëmbyer dhe faturat e lëshuara midis palëve, duke filluar nga koha e nënshkrimit të marrëveshjes.

“Vodafone Albania”sha është përgjigjur me shkresën nr. Prot 1719/12, datë 18.10.2018, në të cilën ka përfshirë informacionin e mëposhtëm:

- *Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimeve të interkoneksionit midis Unifi Holding INC dega Shqipëri dhe Vodafone Albania ka filluar prej muajit Korrik kur eshte lidhur marreveshja e interkonjeksiioni dhe ka vijuar deri në muajin Dhjetor 2017 sipas kontrates.*
- *Vodafone Albania në fund të muajit dhjetor 2017 ka ndaluar së ofruari shërbimin e terminimit pasi Unifi Holdings INC Dega Shqipëri nuk ka pranuar tarifën e re të terminimit komunikuar nga Vodafone Albania.*
- *Marrëveshja me Unifi Holdings INC dega Shqipëri është ndërprerë përfundimisht me çinstalimin e pajisjeve të UNIFI nga ambientet e Vodafone Albania ne datë 10.08.2018, kryer kjo me kërkesë të Unifi Holdings INC dega Shqipëri. Vodafone Albania ka paraqitur Tabelë me trafikun ndërkombëtar të terminuar nga Unifi Holdings INC dega Shqipëri, për secilin muaj për periudhën Korrik 2014-Dhjetor 2017, duke përfshirë dhe shumat e faturuara cdo muaj me dha pa TVSH.*

Bashkëlidhur shkresës së Vodafone Albania sh.a është paraqitur në formë tabelare trafiku i kryer për vitet 2014-2017. Grupi i inspektimit, për të qartësuar marrëdhënien midis dy sipërmarrësve ka kërkuar nga sipërmarrësi “Vodafone Albania” sha (komunikim me e-mail i datës 22.10.2018) kopje të skanuara të faturave tatimore mujore të shitjeve për periudhën Korrik 2014 -Dhjetor 2017. Sipërmarrësi Vodafone Albania (e -mail i datës 25.10.2018) ka vënë ne dispozicion të gjitha faturat tatimore që ka lëshuar në drejtim të sipërmarrësit Unifi Holding INC dega Shqipëri identifikuar me NIPT K92430001J, bazuar në Marrëveshjen e Interkonjeksiionit.

8. Grupi i inspektimit në takimin e datës 25.09.2018 me përfaqësuesit e autorizuar të subjektit Unifi Holdings INC dega Shqipëri ka kërkuar informacion dhe dokumentacion mbi zhvillimin e aktivitetit të këtij subjekti në vitet 2015-2016 dhe 2017 si dhe deklarata për tatim fitimin e këtyre viteve. Në deklaratën e datës 25.09.2018 të nënshkruar nga përfaqësuesit e e autorizuar të subjektit Unifi Holdings INC dega Shqipëri, (administruar nga grupi i inspektimit) deklarohet se i vetmi shërbim i ofruar nga subjekti në këto vite është tranzitimi i thirrjeve në kuadrin e MI me me Vodafone Albania. Pika e sinjalizimit (ISPC) është përdorur vetëm për kryerjen e shërbimeve nga ana e Unifi Holdings INC dega Shqipëri per Vodafone Albania per periudhen Janar - Dhjetor 2017.
9. Është konstatuar se gjatë periudhës Korrik 2014 - Dhjetor 2014 palët kanë kryer këtë shërbim në shkelje të Rregullores nr. 24 datë 02.02.2012 “Për autorizimin e përgjithshëm”, ndryshuar me VKD Nr. 2443, datë 10.04.2014 ku është përcaktuar si më poshtë:

*Aneksi C, pika 5:*

*Caktimi i kodeve te sinjalizimit kombetar (NSPC) dhe nderkombetar (ISPC)*

*Çdo sipërmarrës që kërkon të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike përpara fillimit të ofrimit të tyre, për realizimin e interkoneksionit duhet detyrimisht të pajiset edhe me ISPC. Caktimi nga AKEP-i i NSPC dhe ISPC bëhet mbi bazën e rregullave të përcaktuara në (Akt. Nr. 17 Datë 16.04.2010) “Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”.*

*Për caktimin e NSPC dhe ISPC nga AKEP-i, sipërmarrësi duhet të aplikojë sipas (Akt. Nr. 17 Datë 16.04.2010) “Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”.*

Pra për caktimin e ISPC sipërmarrësi përpara fillimit të aplikimit duhet të ketë siguruar dhe disponojë një marrëveshje paraprake me operatorin/t ndërkombëtarë ku të jetë vendosur edhe ISPC që disponon ky operator ndërkombëtar.

Sqarojmë se sipërmarrësi Unifi Holdings INC dega Shqipëri është pajisur nga AKEP me kod të pikës së sinjalizimit ndërkombëtar vetëm me 13 Dhjetor 2014, pra më pas fillimit të MI.

Në deklaratën e subjektit përcaktohet se dokumentat e kërkuara nga AKEP të listuara më poshtë, nuk janë të aplikueshme për këtë rast, për shkak të aktivitetit të kufizuar të subjektit të inspektimit dhe si të tilla nuk mund të vihen në dispozicion:

- *Kontratën tip me përdoruesit miratuar nga AKEP ku ofronte shërbimin internet;*
- *Lista e përdoruesve të shërbimit internet;*
- *Kopje të kontratës me provaiderin për shërbimin internet;*
- *Faturë shërbimi të detajuar për përdoruesit e shërbimit internet;*
- *Certifikatat e miratimit të pajisjeve që janë në përdorim;*
- *Lista e punonjësve me sigurime shoqërore;*
- *Kohën e fillimit të matjeve të Treguesve të Cilësisë së Shërbimit, në zbatim të pikës 1 dhe pikës 2 të Nenit 11 të “Rregullores për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”;*

- *CD me shtrirjen hartografike të rrjetit si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për plotësimin e objektit të inspektimit.*

Bashkëlidhur deklaratës, përfaqësuesit e Unifi Holdings INC dega Shqipëria, kanë dorëzuar librin e shitjeve, librin e blerjeve dhe FDP për muajin Qershor 2017.

Gjithashtu, Grupi i Inspektimit nëpërmjet mesazhit elektronik të datës 17.10.2018 ka kërkuar nga përfaqësuesit e subjektit informacion dhe dokumenta mbi deklaratat e pagesës mbi tatim fitimin për periudhën 2016-2017 të cilat nuk rezultojnë të dërguara nga subjekti.

Në datë 19.10.2019, nga grupi inspektimit përpilohet proces verbal inspektimi i cili i dërgohet në rrugë elektronike për njohje, mendim dhe sqarim subjektit Unifi Holdings INC dega Shqipëri (e mail dt. 22.10.2018).

Përfaqësuesit e autorizuar të subjektit në shkresën sqaruese të datës 25.10.2018 mbi procesverbalin paraprak të inspektimit ndër të tjera pohojnë se faturat e lëshuar nga Vodafone Albania për vitet 2014, 2015 dhe 2016 janë lëshuar gabimisht në drejtim të degës së të ndodhur në Shqipëri si rezultat i konfuzionit në emrat e entiteteve.

Bashkëlidhur kësaj shkrese vetë përfaqësuesit e subjektit kanë vënë në dispozicion *fatura tatimore të shitje lëshuar nga shitësi Vodafone Albania sha për Blerësin me NIPT K92430001J, të datës 31.08.2014 dhe datës 31.11.2014.*

Të gjitha faturat konstatohen të jenë i njëjti format për të gjithë periudhën kohore 2014-2017 pra me asnjë ndryshim nga viti 2017 të cilin subjekti e ka deklaruar pranë organeve përkatëse.

*Përfaqësuesit autorizuar të subjektit kanë marrë në dorëzim dhe firmosur pa rezerva proces verbalin e inspektimit Nr. 224, datë 26.10.2018.*

10. Grupi i inspektimit në procesverbal inspektimi ka evidentuar faktin se sipërmarrësi “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” në vitin 2014 është pajisur nga AKEP me një seri numerike prej 1000 numrash të cilët, nga deklaratimet statistikore nuk figuron trafik kombëtar i origjinuar nga përdoruesit. Për rrjedhojë, sipërmarrësi “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” gjatë viteve 2014-2017 nuk ka pasur përdorues të shërbimit të telefonisë fikse.
11. Në muajin Dhjetor 2014, sipërmarrësi “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” është pajisur nga AKEP me kod të pikës së sinjalizimit kombëtar (NSPC) si dhe kod të pikës së sinjalizimit ndërkombëtar (ISPC) i cili është përdorur për të kryer shërbimin e tranzitit dhe terminimit ndërkombëtar. Nga verifikimet rezulton se marrëveshja e interkoneksionit midis “Vodafone Albania” sha dhe “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” është lidhur me datë 01.07.2014 si dhe shërbimi i terminimit të thirrjeve sipas deklaratimeve të Vodafone ka filluar po këtë muaj ndërsa sipërmarrësi “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” është pajisur me numeracion dhe me kod të pikës së sinjalizimit ndërkombëtare (ISPC) datë 13.12.2014, pra rreth 6 muaj me vonë. Lidhur me pagesat e detyrimeve për numeracionin, subjekti ka paguar rregullisht për këto vite, detyrimin e tij pranë AKEP.
12. Marrëdhënia e Interkoneksionit të subjektit është pasuar nga lëshimi i faturave tatimore të shitjeve me TVSH të lëshuara nga sipërmarrësi Vodafone Albania sha për blerësin Unifi

Holdings INC, dega Shqipëri identifikuar me NIPT K92430001J, të cilat janë konform përcaktimeve të nenit 49 të ligjit nr. Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, i cili përcakton se: *Fatura tatimore përmban numrin rendor dhe numrin personal të identifikimit, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit apo shërbimit, emërtimin e saktë të tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe, nëse është rasti, rritjet ose zbritjet e tjera, të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës.*

13. Referuar këtyre faturave të cilat përcaktojnë qartë të gjithë elementët ligjor të sipërpërmendur dhe të adresuara drejt subjektit Unifi Holdings INC dega Shqipëri me numër identifikimi NIPT K92430001J, vërtetojnë se ky subjekt ka zhvilluar veprimtari edhe në vitet 2014, 2015 dhe 2016. Në kushtet kur subjekti Unifi Holdings INC dega Shqipëri është subjekt tregtar i regjistruar në Regjistrin e Qendres Kombetare të Regjistrimit në Republikën e Shqipërisë me NIPT K92430001J ka detyrimin ligjor të nënshtrohet detyrimeve të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar në aspektin financiar dhe tatimor.
14. Bazuar në Rregulloren Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, *Përfaqësuesi i subjektit është përgjegjës për vënien në dispozicion të inspektorëve të: dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar, **ambjentëve teknologjike ku janë instaluar pajisjet, infrastrukturës së rrjetit dhe faciliteteve shoqërore.*** Në këtë aspekt konkludojmë se subjekti megjithëse kishte marrë dijeni se AKEP do të kryente inspektim të ri brenda muajit Shtator 2018 (bazuar kjo në Vendimin nr 54, datë 03.08.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP), ky subjekt në datën 10.08.2018 ka çmontuar pajisjet nëpërmjet të cilave kryente shërbimin e tranzitimit të thirrjeve drejt Vodafone Albania sh.a dhe që kishte të instaluar në ambientet e këtij të fundit (referuar kjo deklaratës së subjektit datë 25.09.2018 si edhe shkresës nr.1719/12 prot, datë 18.10.2018 të Vodafone Albania sha). Në këtë aspekt mos përmbushja e detyrimit sipas autorizimit të inspektimit për verifikimin e paisjeve nga grupi i inspektimit konsiderohet pengim në realizimin e objektit të inspektimit. **Heqja e këtyre paisjeve përpara fillimit të inspektimit, megjithë informacionin për zhvillimin e inspektimit, pengoi grupin e inspektimit të kryente verifikimin e CDR për trafikun e kryer në periudhën kohore 2014 – 2017.**
15. Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në materialet dhe dosjen e inspektimit, grupi i inspektimit ka konstatuar shkeljet ligjore të kryera nga sipërmarrësi “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” si më poshtë:  
Sipërmarrësi “Unifi Holdings Inc, Dega në Shqipëri” sh.p.k nuk ka dorëzuar të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët sipas afateve kohore të përcaktuara në Autorizimin e Inspektimit .

#### **Subjekti i inspektimit nuk ka vënë në dispozicion të inspektimit:**

- Certifikatat e miratimit të pajisjeve që janë në përdorim;
- Lista e punonjësve me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- Kohën e fillimit të matjeve të Treguesve të Cilësisë së Shërbimit, në zbatim të pikës 1 dhe pikës 2 të Nenit 11 të “Rregullores për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”;



- Deklaratat e tatim fitimit për vitet 2015-2017
- Si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për plotësimin e objektit të inspektimit.

Për më tepër nga informacioni i depozituar nga sipërmarrësi objekt inspektimi përmes pasqyrave financiare të depozituara në organet tatimore dhe pranë grupit të inspektimit rezulton se ai nuk ka kryer aktivitet në vitet 2014-2016 ndërkohë nga informacioni i përfutur nga “Vodafone Albania” sh.a dhe nga faturat tatimore të vëna në dispozicion nga vetë subjekti nepërmjet shkresës të datës 25.10.2018, në zbatim të marrëveshjes së interkoneksionit ndërkombëtar midis dy sipërmarrësve rezulton se “Unifi Holdings Inc, Dega Në Shqipëri” ka kryer aktivitetet edhe në periudhën e cituar.

*Sa më sipër grupi i inspektimit ka konkluduar se sipërmarrësi “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” ndodhet në rastin e mosdorëzimit të dokumentacionit pranë grupit të inspektimit dhe mos deklarimit të të ardhurave, pasi me gjithë kërkesën e vazhdueshme të grupit, subjekti nuk ka paraqitur deklarin e të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike (tranzit thirrje hyrëse ndërkombëtare) për vitet 2014, 2015, 2016 në organet tatimore dhe AKEP.*

Mosdhënia e dokumentacionit ka të beje në rastin konkret edhe me fshehje të qëllimshme të tij për të penguar punën e grupit të inspektimit.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë inspektimit, meqenëse subjekti objekt inspektimi ka ofruar shërbime edhe gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 (referuar shkresës nr 1719/12 prot, datë 18.10.2018 të Vodafone Albania sh.a si dhe faturave tatimore të shitjes për vitet respektive, por edhe shkresës dhe deklarimeve të subjektit) deklarohet se nuk ka pasur aktivitet në këto vite, rrjedhimisht rezulton se ky subjekt ka shmangur detyrimet financiare si ndaj AKEP ashtu edhe ndaj organeve të tjera përgjegjëse.

Në përfundim të veprimtarisë inspektuese, Grupi i Inspektimit pranë AKEP, ka kualifikuar shkeljet e konstatuara si më sipër, si kundërvajtje administrative në referim të nenit 135, pika 1, germa a) të **ligjit 9918/2008**: “...kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo person tjetër fizik a juridik, që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara: i propozojnë Këshillit Drejtues të AKEP-it masën e gjobës sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët I deri në IV të tij, dhe masat për ndreqjen e shkeljes së konstatuar”. Sa më sipër, referuar nenit 16 dhe nenit 137, pika 1, paragrafi I-rë, nën pika 19, paragrafi V, nënpika 2, si dhe paragrafi VII i **ligjit 9918/2008**, grupi i inspektimit ka propozuar penalizmin me masë administrative me gjobë sipërmarrësin “Unifi Holding INC, dega Shqipëri” pasi nuk ka dorëzuar të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët, sipas nenit 132 pika 3 të këtij ligji si dhe nuk ka lejuar kryerjen e veprimeve të inspektimit në rastin e verifikimit të pajisjeve. Gjithashtu, propozimi i Grupit të Inspektimit mbështetet dhe nga dispozitat e Rregullores Nr. 46

“Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendim Nr.2695, datë 27.10.2016, ku përcaktohet ndër të tjera se:

*“Subjekti i përcaktuar në autorizimin e inspektimit, me marrjen e njoftimit të inspektimit, është i detyruar ligjërisht dhe merr masat e duhura për t’i mundësuar inspektorëve realizimin e inspektimit. Subjekti i inspektimit edhe në rastet e paraqitjes së inspektorëve pa njoftim paraprak, menjëherë pas paraqitjes nga grupi i inspektimit të autorizimit dhe kartave të inspektorëve, lejon kryerjen e inspektimit duke u angazhuar maksimalisht për të mundësuar kryerjen e veprimeve të inspektimit sipas kërkesave ligjshme të inspektorëve. Përfaqësuesi i subjektit është përgjegjës për vënien në dispozicion të inspektorëve të:*

- dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar,
- ambienteve teknologjike ku janë instaluar pajisjet,
- infrastrukturës së rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, si dhe për:
- bashkëpunimin dhe mos pengimin e kryerjes së veprimeve të inspektimit;
- dhënien e shpjegimeve të nevojshme.

**16.** Neni 135 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se: *Kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara, kanë të drejtë: t’i propozojnë Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare heqjen e së drejtës së përdorimit të frekuencave/numeracionit.*

Për sa më lart, në bazë të nenit 29 të Rregullores nr. 10, datë 11.08.2009 “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”, grupi i inspektimit ka propozuar që AKEP të heq të drejtën e përdorimit të numeracionit për subjektin Unifi Holdings INC dega Shqipëri, pasi mbajtësi i numrave nuk ka filluar të përdor numrat / bllokun e numrave brenda një periudhë prej tri vitesh që nga data e caktimit.

**17.** Këshilli Drejtues i AKEP në mbledhjen e datës 13.11.2018, është njohur me propozimin e grupit të inspektimit për penalizimin me masën administrative kryesore “Gjobë” si dhe dënimet plotësuese kundrejt subjektit Unifi Holdings INC, dega Shqipëri dhe referuar nenit 87 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe pikës 4 të nenit 135, të ligjit nr. 9918/2008, ka vendosur të njoftoj subjektin e mësipërm për tu paraqitur në seancë dëgjimore datë 20.10.2018, për të dhënë shpjegimet përkatëse, përpara Këshillit Drejtues.

Subjekti është njoftuar nëpërmjet shkresës nr. 1719/16 Prot të datës 13.11.2018.

**18.** Në mbledhjen e datës 20.11.2018, në bazë të autorizimit të përfaqësimit të datës 16.11.2018, subjekti Unifi Holdings INC dega Shqipëri është përfaqësuar nga Av. Sokol Elmazaj dhe Av. Andi Pacani. Në seancën dëgjimore, përfaqësuesit e subjektit pretenduan se subjekti nuk ka zhvilluar veprimtari për vitet 2015, 2016, dhe nuk kishin dijeni mbi faturat e lëshuara nga Vodafone Albania sha dhe pretenduan se këto fatura janë lëshuar

gabim në drejtim të subjektit Unifi Holdings INC dega Shqiperi, pasi duhet të lëshoheshin për shoqërinë mëmë.

Përfaqësuesit e grupit të inspektimit sqaruan se faturat tatimore të shitjes nga Vodafone Albania sh.a janë lëshuar drejt subjektit Unifi Holding INC në numër NIPT të degës Shqipëri K92430001J si dhe në funksion të Marrëveshjes së Interkoneksionit midis Vodafone Albania dhe Unifi Holdings INC dega Shqipëri. Nga verifikimi teknik rezulton se e vetmja pikë interkoneksioni e deklaruar për të kryer tranzitimin e thirrjeve midis Vodafone Albania sh.a dhe Unifi Holdings INC dega Shqipëri ndodhej në ambientet e Vodafone Albania sha. Përfaqësuesit e subjektit deklaruan se për tre vite (2014, 2015 dhe 2016) subjekti nuk ka zhvilluar aktivitet dhe kjo bazuar në pasqyrat financiare të dorëzuara në QKB nga subjekti Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri, por aktivitet ka zhvilluar vetëm në vitin 2017 vërtetuar kjo me pasqyrat financiare përkatëse.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në referim të pikës 1, të nenit 65, si dhe neneve 132 e vijues të *ligjit nr. 9918/2008*, neneve 98 e vijues të *ligjit nr. 44/2015*, pikës 3.9 të *Rregullores Nr.46*, si dhe duke pasur në vëmendje kriteret për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit në referim me *Ligjin 10279/2010*, Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, pasi shqyrtoi propozimin e grupit të inspektimit, të ngritur me autorizimin e Inspektimit Nr. 1719/8 Prot, datë 06.09.2018,

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë propozimin e inspektorëve, për dhënien e masës administrative me gjobë, në vlerën 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë, ndaj sipërmarrësit “Unifi Holding INC, dega Shqipëri”.
2. Heqjen e së drejtës së përdorimit të numeracionit të caktuar për sipërmarrësin “Unifi Holdings INC, dega Shqipëri”.
3. Çështja të referohet për vlerësim të mëtejshëm në organet tatimore, konkretisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim kryerjen e një hetimi më të hollësishëm lidhur me veprimtarinë tregtare dhe financiare të ushtruar nga shoqëria “Unifi Holdings INC” dega Shqipëri për vitet 2014, 2015 dhe 2016.
4. Çështja të referohet për vlerësim (mbështetur në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale) në organin e Prokurorisë Tiranë, pasi ka dyshime të arsyeshme që në veprimtarinë e ushtruar nga subjekti Unifi Holding INC dega Shqipëri për vitet 2014, 2015 dhe 2016 mund të ketë shkelje ligjore që përbëjnë element të veprës penale.

5. Ngarkohet grupi i inspektimit të ngritur me Autorizimin e Inspektimit nr. 1719/8 Prot, datë 06.09.2018, për hartimin e vendimit përfundimtar të inspektimit sipas këtij vendimi.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit 45 ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Illir ZELA</b>	<b>Klarina ALLUSHI</b>	<b>Ketrin TOPÇIU</b>	<b>Edlira DVORANI</b>